



**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN  
E MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2015**

**TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:  
PROFILI MËSIMOR “SHËRBIME BANKARE”  
(DREJTIMI MËSIMOR “EKONOMI-BIZNES”)**

**Janar, 2015**

## 1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve të profilit “**Shërbime bankare**”, me strukturë 2+2, për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale” e integruar të Maturës Shtetërore Profesionale 2015. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testeve të përmblendhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- programin orientues për Provimet Përfundimtare në drejtimin “Ekonomi-Biznes”, Niveli I;
- programet e lëndëve teorike profesionale të profilit “Shërbime bankare”, Niveli III (klasa e 12-të dhe 13-të);
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MMSR nr. 2, datë 06.02.2015 “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2015 në Republikën e Shqipërisë”.
- Rregulloren e Maturës Shtetërore 2015 në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhërin e Ministrit nr.61, datë 10.02.2015.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve dhe që janë në themel të formimit teorik profesional të nxënësit.

## 2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të kësaj lënde, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për profilin mësimor “**Shërbime bankare**” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e

përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

### 3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “**Teorisë profesionale të integruar**” në kuadrin e provimit me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për profilin mësimor “**Shërbime bankare**”, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtëme:

1. Njohuri në Mikroekonomi, kl. 10
2. Njohuri në Makroekonomi, kl. 11
3. Ekonomi ndërmarrjeje, kl. 10 dhe kl. 11
4. Njohuri tregtare, kl. 10 dhe kl. 11
5. Llogari dhe kontabilitet, kl. 10 dhe kl. 11
6. Bankat dhe sistemi financiar, kl. 12
7. Marketingu dhe shërbimet bankare, kl. 12
8. Teknika bankare, kl. 12 dhe kl. 13
9. Kontabiliteti bankar, kl. 12 dhe kl. 13
10. E drejta dhe legjislacioni, kl. 13
11. Sjellje sipërmarrës, kl. 13
12. Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kl. 13.

**Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues**

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Njohuri në Mikroekonomi	32	10
2	Njohuri në Makroekonomi	20	7
3	Ekonomi ndërmarrjeje	46	16
4	Njohuri tregtare	22	8
5	Llogari dhe kontabilitet	38	12
6	Bankat dhe sistemi financiar	17	5
7	Marketingu dhe shërbimet bankare	9	3
8	Teknika bankare	39	12
9	Kontabiliteti bankar	34	11

<b>10</b>	E drejta dhe legjislacioni	18	5
<b>11</b>	Sjellje sipërmarrëse	17	6
<b>12</b>	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	14	5
	<b>TOTALI</b>	<b>306</b>	<b>100%</b>

**Temat sipas lëndëve janë:**

- a) **“Njohuri në Mikroekonomi”**, kl.10: **(32 orë)**
- Kërkesa, oferta, funksionimi i tregjeve dhe ekuilibri i tyre. 20 orë
  - Tregjet e faktorëve të prodhimit 12 orë
- b) **“Njohuri në Makroekonomi”**, kl.11: **(20 orë)**
- Paraja dhe institucionet financiare 10 orë
  - Inflacioni, papunësia dhe ciklet e biznesit 10 orë
- c) **“Ekonomi ndërmarrjeje”**, kl.10 dhe kl.11: **(46 orë)**
- Ndërmarrja në ekonominë e tregut 20 orë
  - Financimi nga kapitali i vet 12 orë
  - Financimi nga kapitali i të tretëve 14 orë
- d) **“Njohuri tregtare”**, kl.10 dhe kl.11: **(22 orë):**
- Komunikimi në një ndërmarrje tregtare 12 orë
  - Njohja me produktin dhe mallin në pikën e shitjes 6 orë
  - Teknologjitë e informimit dhe të shitjes 4 orë
- e) **“Llogari dhe kontabilitet”**, kl.10 dhe kl.11: **(38 orë)**
- Inventarizimi, inventarët dhe bilanci 6 orë
  - Pasqyrimi kronologjik i veprimeve ekonomik 4 orë
  - Llogaritë e rezultatit 4 orë
  - Llogaritë e mallrave 4 orë
  - Tatimi mbi vlerën e shtuar 4 orë
  - Aktivët e qëndrueshme dhe regjistrimet që lidhen me to 6 orë
  - Regjistrimet kontabël në fushën e personelit 6 orë
  - Qarkullimi i pagesave dhe regjistrimet përkatëse kontabël 4 orë
- f) **“Bankat dhe sistemi financiar”**, kl.12: **(17 orë)**
- Struktura e sistemit bankar shqiptar 8 orë
  - Banka e Shqipërisë 9 orë

g) <b>“Marketingu dhe shërbimet bankare”</b> , kl.12:	<b>(9 orë)</b>
• Produkti	2 orë;
• Çmimi	2 orë
• Shpërndarja	3 orë
• Promocioni	2 orë
h) <b>“Teknika bankare”</b> , kl.12 dhe kl. 13:	<b>(39 orë)</b>
• Aktiviteti bankar dhe funksionet e tij	5 orë
• Depozitat e kursimit	10 orë
• Llogaritë rrjedhëse	9 orë
• Kredithënia bankare	9 orë
• Garancitë bankare dhe marrja e angazhimeve	6 orë
i) <b>“Kontabiliteti bankar”</b> , kl.12 dhe kl.13:	<b>(34 orë)</b>
• Llogaritë e shpenzimeve bankare dhe parimet e llogaritjes së rezultatit:	2 orë
• Kontabilizimet e derdhjeve dhe pagesave me para në dorë në llogaritë rrjedhëse të klientëve	2 orë
• Veprimet dhe kontabilizimet me llogaritë e depozitave:	4 orë
• Regjistrimet kontabël të akordimit të llojeve të ndryshme të kredive:	4 orë
• Llogaritja e interesave të kredive dhe kontabilizimi i tyre. Shlyerja tërësore ose me këste e kredive	4 orë
• Llogaritja dhe kontabilizimi i interesave të llogarive rrjedhëse:	6 orë
• Hartimi i bilanceve të thjeshta ditore:	6 orë
• Llogaritja dhe regjistrimi i shpenzimeve të tjera bankare:	6 orë
j) <b>“E drejta dhe legjislacioni”</b> , kl.13:	<b>(18 orë)</b>
• Legjislacioni i punësimit dhe sigurimeve shoqërore:	8 orë
• Legjislacioni për ndërmarrjet (Ligji për shoqëritë tregtare)	10 orë
k) <b>“Sjellje sipërmarrëse”</b> , kl.13:	<b>(17 orë)</b>
• Qëllimet sipërmarrëse:	6 orë
• Motivimet: Të menduarit sipërmarrës:	6 orë
• Roli i emocioneve në vendimmarrjen sipërmarrëse	5 orë
l) <b>Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm</b> , kl. 13:	<b>(14 orë)</b>
• Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
• Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis	3 orë
• Zhvillimet demografike dhe mjedisi	4 orë
• Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë

